



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:253233

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05236347

**Në ankesën e**

**AC-I-23-0069**

**Paditësi**

**I R**, nga Gjilani, i përfaqësuar nga avokati **B I**, Prishtinë.

**kundër**

**E paditura/Ankuesja**

**NSH, N.H.N.I "Morava e Binqës"(në likuidim)**, të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1833 të datës 30 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1833 i datës 30 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

### **Padia në DHPGJS**

Me 03 tetor 2008 paditësi dhe 755 punëtor tjerë të NSH "Morava e Binqës" kanë parashtruar padi në DHPGJS me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura NSH "Morava e Binqës", që në emër të kompensimit të ardhurave personale të papaguara për 764 punëtor, për periudhën prej 01 janar 2002 e deri më 31 mars 2008 të paguaj shumën prej 72,985.17 € dhe në emër të pagesës së kontributeve pensionale, në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, për periudhën prej 01 gusht 2002 e deri më 31 mars 2008 të paguaj shumën prej 328,956.74. Kjo padi është regjistruar në DHPGJS me numrin SCC-08-0266.

Me 9 korrik 2009 DHPGJS-ja, e ka referuar padinë SCC-08-0266 për gjykim në Gjykatën Komunale në Gjilan, me të drejtë ankese në DHPGJS dhe e ka ftuar si palë në gjykim AKP-në.

Me 23 nëntor 2011, paditësit parashtruan një parashtresë në Gjykatën Komunale në Gjilan, me të cilën bënë precizimin e padisë. Sipas kësaj parashtrese kompensimi i të ardhurave personale është kërkuar të bëhet për periudhën 01 janar 2006 e deri më 09 gusht 2010, dhe është precizuar shuma e përgjithshme e kërkuar prej 111,205.54 €, ndërsa kërkesat e tyre në emër të pagesës së kontributeve pensionale në llogarinë e Trustit të Kursimeve Pensionale, për periudhën prej 01 gusht 2002 e deri më 09 gusht 2010, shuma e përgjithshme 404,049.25 €, vlera totale për paga dhe kontribute precizohet në shumën prej 515,254.79 €. Me këtë parashtresë gjithashtu është bërë edhe precizimin i numrit të paditësve dhe numri përfundimtar i paditësve është 756.

Më 30 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Gjilan me Aktgjykimin e ankimuar C.nr.458/2009 e aprovon kërkesëpadinë e 756 paditësve dhe e detyron të paditurën që në emër të kontributeve pensionale në llogarinë e Trustit të Kursimeve Pensionale, për periudhën prej 01 gusht 2002 e deri më 09 gusht 2010, të paguaj shumën prej 404,049.25 €, dhe në emër të të ardhurave personale për periudhën 01 janar 2006 e deri më 09 gusht 2010, të paguaj shumën prej 111,205.54 €, gjithsejtë shuma totale për paga dhe kontribute e detyruar për pagesë është 515,254.79 €, dhe është obliguar e paditura që paditësve tu a paguan shpenzimet

e procedurës kontestimore në shumë prej 330 €, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Me 9 shkurt 2012, AKP-ja si përfaqësuese e të e paditurës (në tekstin vijues ankuesja) paraqet ankesë ndaj aktgjykimit të cekur më lartë të Gjykatës Komunale në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesja ka kërkuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësve si e pa bazuar ose ta anulohet aktgjykimi i atakuar dhe padia e paditësve të hedhet poshtë si të papranueshme.

Kjo ankesë regjistrohet në DHPGJS me numrin AC-II-12-0013.

Me datë 27 qershor 2013, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-II-12-0013 ankesën e AKP-së e aprovon si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e Gjykatës komunale në Gjilan, C.nr.458/2009 të datës 30 dhjetor 2011 dhe padinë e kthen në rigjykim në Kolegjin përkatës të Specializuar të DHPGJS-së. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se Autorizimi për përfaqësim të 756 ankuesve i është dhënë avokatit, nga Kryetari i Sindikatës së punëtorëve, e jo drejtë për së drejti nga punëtorët, prandaj ai dokument në mungesë të nënshkrimeve të punëtorëve/ankuesve është jo valid. Prandaj është e qartë se Gjykata komunale me aktgjykimin e ankimuar kishte shkelur nenin 182.2, nën pika k) të LPK-së pasi që paditësit si palë në procedurë janë përfaqësuar nga një Avokat me autorizim jo valid. Përfundimi i Kolegjit të Apelit për këtë çështje është se avokati në bazë të këtij "autorizimi" nuk ka mundur t'i përfaqësojë paditësit në procedurë, andaj aktgjykimi i ankimuar për shkak të kësaj shkelje procedurale nuk mund të qëndroj, dhe duhet anuluar.

Zyra e regjistrimit e DHPGJS-së, lëndën e kthyer në rigjykim e regjistron me numrin, C-II-13-0183.

Me datë 16 tetor 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendimin C-II-13-0183 e pezullon procedurën lidhur me padinë, për shkak se ndaj NSH-së "Morava e Binqës" ka filluar procedura e likuidimit me datë 03.06.2013.

## **Padia në procedurën e likuidimit**

Me datë 04 korrik 2013, paditësi e dorëzoi tek Autoriteti i Likuidimit i NSH "Morava e Binqës", një kërkesë për kompensimin e kontributeve pensionale, në shumë prej 731.00 euro për periudhën 2002-2010, të cilën kërkesë e bazon në Aktgjykimin e Gjykatës komunale në Gjilan, C.nr.458/2009 të datës 30 dhjetor 2011.

Me datë 21 gusht 2013, Autoriteti i Likuidimit me Vendimin GJI037-0192, kërkesën e paditësit për pagesën e kontributeve pensionale, në shumë prej 731.00 euro për periudhën 2002-2010, e refuzon si të pavlefshme. Autoriteti i Likuidimit refuzimin e kërkesës e ka bazuar në faktin se Aktgjykimi i Gjykatës komunale në Gjilan C.nr.458/2009 të datës 30 dhjetor 2011, nuk është i formës së prerë. Tutje Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se do ta shqyrtoj kërkesën dhe shuma që do të gjykohet e vlefshme, nuk do ti paguhet paditësit por Trustit të kursimeve pensionale në Kosove në bazë të deklarimeve në emër të kontributeve pensionale të paraqitura nga ndërmarrja të Administrata Tatimore e Kosovës.

Me datë 26 shtator 2013, përmes postës paditësi e dërgoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI037-0192, të datës 21 gusht 2013, me të cilën kërkesa e paditësit është refuzuar si e pa vlefshme. Ne ankesë paditësi ka pretenduar që refuzimi i kërkesës për pagesën e kontributeve pensionale për periudhën 2002-2010 nga NSH "Morava e Binqës", nuk është i bazuar në Ligj. Tutje në ankesë ai kërkon që lidhur në ankesën e paraqitur ndaj Aktgjykimit C.nr.458/2009 të datës 30 dhjetor 2011, duhet të vendos DHPGJS-ja.

Me datë 12 janar 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se vendimi i ankimuar nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit të AKP-së, prandaj nuk ka bazë ligjore të shfuqizohet vendimi i ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka ofruar ndonjë argument juridik në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, andaj ky vendim është i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me datë 02 shkurt 2018, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtën në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë ai pohon se atij nuk janë paguar kontributet pensionale në shume prej 731.00 euro për periudhën 2002-2010 nga ana e të paditurës, andaj pa pasur bazë ligjore është refuzuar kërkesa me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Me këtë parashtresë ai dorëzon kopjen e librezës se punës, kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.458/2009 të datës 30 dhjetor 2011 dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 01 mars 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsërit pretendimet e veta të cekur në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 16 janar 2013, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV.-13-1833, e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe e aprovon kërkesën duke e detyruar të paditurën të paguaj në emër të kontributit pensional shumen prej 731.00 euro , e cila shume duhet të paguhet në Trust të Kursimeve Pensionale të Kosovës sipas nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se AKP-ja me mbrojtën në ankesë nuk është deklaruar fare se a ka vepruar në pagimin e kontributeve për pension të punëtoreve, por vetëm është deklaruar se këto kërkesa paguhet në Trust. Nisur nga kjo rrethane e zbatimit të gabuar të drejtës materiale nga ana e AKP-së kur e ka refuzuar kërkesën, Gjykata vlerëson se kërkesa për pagesën e kontributeve pensionale është pjese e kërkesës për pagesën e pagave kështu që është aprovuar ankesa e paditësit dhe është detyruar AKP-ja të paguaj kontributet pensionale për këtë paditës në shumen 731.00 euro, e cila shume do të paguhet në Trust të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Me datë 25 janar 2023, Avokati i paditësit e dorëzon një parashtresë në DHPGJS, dhe kërkon që të korrigohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV.-13-1833 të datës 16 janar 2023, dhe atë si vijon *'' në faqen 1 tek pjesa hyrëse emri i palës është shkruar gabimisht I e duhet të jete I , po ashtu ky emër është shkruar gabimisht edhe tek pjesa e dispozitivit të Aktgjykimit I e duhet të jete I ''*.

Me datë 30 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-IV.-13-1833 e korrigjon gabimin e cekur në pjesën hyrëse, dhe në dispozitiv të Aktgjykimit, të

vend të emrit I që është shënuar gabimisht, duhet të jete emri I . Pjesa tjetër e Aktgjykimit mbetet e pa ndryshuar .

Me datë 06 shkurt 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-13-1833 të datës 16 janar 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Shkalla e I-rë ka juridiksion vetëm të verifikoj ligjshmërinë e vendimit të Autoriteti të Likuidimit e jo të vendos në merita pa i marrë për bazë faktet dhe argumentet e ngritura nga Autoriteti i Likuidimit. AKP-ja kërkon që çështja të trajtohet edhe njëherë dhe të merren në konsiderate argumentet e Autoritetit të Likuidimit të dhëna në vendimin e ankimuar.

Me datë 04 prill 2023, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të cilin e konsideron si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Paditësi pretendon se në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike me provat e administruara nga Shkalla e I-rë dhe gjithashtu në mënyrë të drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar. Paditësi në këtë parashtresë i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit dhe Shkallës së I-rë të DHPGJS-së.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e të paditurës refuzohet e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 04 korrik 2013, e dorëzon një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për kompensimin e kontributeve pensionale në shumë prej 731.00 euro për periudhën 2002-2010. Këtë kërkesë ai e mbështet në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, C.nr.458/2009 të datës 30 dhjetor 2011.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se me Aktvendimin, AC-II-12-0013 të datës 27 qershor 2013, ishte aprovuar ankesa e AKP-së, dhe ishte anuluar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.458/2009 të datës 30 dhjetor 2011, dhe padia ishte kthyer në rigjykim në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me datë 16 tetor 2017 me Aktvendimin C-II.-13-0183, e pezullon procedurën lidhur me padinë e paditësit për kompensimin e kontributeve pensionale, për shkak se NSH-ja është në procedurën e likuidimit nga data 03.06.2013.

Nga kjo gjendje faktike që u tha me sipër, del që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.458/2009 i datës 30 dhjetor 2011, në të cilin paditësi e mbështet kërkesën e tij për kompensimin e kontributeve pensionale në shume prej 731.00 euro, nuk është në fuqi, ai Aktgjykim është anuluar, andaj paditësi nuk ka bazë ligjore të thirret më në këtë Aktgjykim.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimin e kontributeve pensionale me arsyetimin që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, C.nr.458/2009 i datës 30 dhjetor 2011, nuk është i formës së prerë, gjë që ky konstatim ishte i drejtë, ndërsa me datë 27 qershor 2013, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-II-12-0013, siç u tha më sipër e anuloi këtë Aktgjykim.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se në lëndën C-II-13-0183, në të cilën lëndë Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e kishte pezulluar procedurën lidhur me padinë, për shkak se ndaj NSH-së ka filluar procedura e likuidimit me datë 03.06.2013, në këtë lëndë

paditësi kishte sjellë prova të mjaftuara për ta mbështetur kërkesën e tij e cila është e njëjtë me këtë lëndë. Në këtë lëndë të pezulluar është lista e punëtorëve për kompensimin e kontributeve pensionale dhe të ardhurave personale të lëshuar nga NSH "Morava e Binqës", Nr.171, e datës 12.08.2008, është një konfirmim i lëshuar nga NSH-ja për të gjithë 764 punëtorët e evidentuar në listën e punëtorëve, për kompensimin e kontributeve pensionale, si dhe autorizimi i avokatit.

Duke u mbështetur në dy provat e cekura të cilat janë marrë nga lënda e pezulluar C-II-13-0183, Kolegji i Apelit konstaton se me të drejtë Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e kishte aprovuar kërkesën e paditësit dhe e ka detyruar të paditurën që të paguajë shumën 731.00 euro në emër të kontributit pensional.

Prandaj duke u bazuar në këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e AKP-së si të pa bazuar dhe e vërteton Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 21 shkurt 2023, për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_